



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr. 817/8 prot.

Tiranë, më 28.04.2025

VENDIM

Nr.06, datë 28.04.2025

PËR

RRËZIMIN E ANKESËS

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 9/1, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Znj. (në vijim “ankuesja”), ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”), ankesën nr. 817/7 Prot., datë 16.04.2025, me objekt “*Ankim për zbatimin e ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar*”, kundër Autoritetit Publik/ Bashkia Tiranë/Drejtoria e Përgjithshme e Kopshtit Zoologjik (në vijim “Autoriteti Publik”).

Ankuesja, me anë të shkresës së sipërcituar, kërkon nga Komisioneri: “...zbatimin e përcaktimeve ligjore të nenit 18 pika 1 dhe 2 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar (në vijim “LDI”), në të cilin sqarohet se mosrespektimi i dispozitave të këtij ligji passjell përgjegjësi administrative, si dhe veprimet dhe mosveprimet konsiderohen kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë.

Në nenin 19 pika 4, shkronja “a”, qartësisht shprehet: “Çdo person përgjegjës, i cili me veprimet ose mosveprimet e tij shkel dispozitat e këtij ligji, ka përgjegjësi administrative për kundërvajtjet administrative të parashikuara në shkronjës “a”.

Nga shqyrtimi i çështjes, Komisioneri konstaton se, ankuesja me anë të kërkesës datë 02.02.2025, depozituar nëpërmjet shërbimit postar me nr. dëftese 1020., datë 03.02.2025, ka kërkuar t'i vendoset në dispozicion dokumentacioni, si vijon:

- *Të gjithë praktikën e ndjekur nga Drejtoria e Përgjithshme e Kopshtit Zoologjik për iniciimin e procedurës për nxjerrjen e urdhrin nr. 32, datë 09.01.2025 të Kryetarit të Bashkisë, ku përfshihet çdo dokumentacion i mbajtur nga institucioni mbi propozimet, argumentimet mbi konstatimet faktike të funksionimit të DPKZ dhe arsyetimet ligjore;*
- *Urdhrin nr. 32, datë 09.01.2025 të Kryetarit të Bashkisë, së bashku me organizigramën dhe strukturën analitike.*

Në mungesë të një përgjigje, me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim ankuesja i është drejtuar Zyrës së Komisionerit me ankesën e regjistruar me nr. 817 prot., datë 04.03.2025 (saktësuar me nr. 817/2 Prot., datë 17.03.2025), duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit, si dhe urdhërimin e Autoritetit Publik për dhënien e dokumentacionit të kërkuar.

Zyra e Komisionerit, pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, të përcaktuara në nenin 24 të LDI.

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, me qëllim verifikimin e fakteve dhe rrethanave, që mund të jenë bërë pengesë për kthimin e përgjigjes/vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar, me Urdhrin nr. 60, datë 18.03.2025, Komisioneri vendosi fillimin e hetimit administrativ pranë Autoritetit Publik.

Në këto kushte, pranë Autoritetit Publik u depozitua urdhri i inspektimit administrativ, i cili u protokollua me nr. 230 Prot., datë 20.03.2025.

Në vijim, koordinatorja për të drejtën e informimit pranë Autoriteti Publik, nëpërmjet e-mail-it datë 25.03.2025, ka vendosur në dispozicion një përgjigje të Drejtorisë së Përgjithshme të Kopshtit Zoologjik, me anë të së cilës ka sqaruar se: *“Znj. është lëvizur në detyrë për shkak të ristrukturimit të miratuar me Urdhrin nr. 32, datë 09.01.2025 të Kryetarit të Bashkisë për “Miratimin e strukturës organike të Drejtorisë së Përgjithshme të Kopshtit Zoologjik”.*

Me hyrjen në fuqi të strukturës së miratuar është vënë në dispozicion nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Edukimit dhe specialisti i protokollit, struktura e miratuar e cila ju është bërë me dije dhe shpërndarë të gjithë punonjësve të Drejtorisë së Përgjithshme të Kopshtit Zoologjik (në vijim “DKPZ”).

Emërimet janë bërë sipas pozicioneve përkatëse dhe znj. nuk e ka pranuar duke e grisur kopjen e saj kur i është dhënë në dorëzim, gjë që është edhe në librin e protokollit që nuk e pranon urdhrin për pozicionin e ri të punës.

Znj. ka dërguar nëpërmjet postës elektronike dhe shkresë zyrtare me postë ku kërkon dokumente të cilat pretendon se nuk i janë vendosur në dispozicion, megjithatë theksojmë se znj. ka marrë përgjigje në shkresën nr. 101/1 prot, datë 28.01.2025 ku i kemi vënë në dispozicion përveç përgjigjes dhe urdhërin e saj të emërimit dhe strukturën e re të miratuar.

Në vazhdimësi znj. e emëruar në pozicionin e saj Specialist i I-rë nuk është paraqitur në punë për më shumë se 7 ditë pune duke e braktisur vendin e punës pa asnjë dokument justifikues si raport mjekësor apo leje e zakonshme.

Duke qenë përballë kësaj situate Sektori i Burimeve Njerëzore, njësia e punës në të cilën është emëruar znj. , pas verifikimit të listëprezencave ndoqi procedurën për shkëputjen e marrëdhënieve financiare siç e parashikon ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” dhe procedoi me nxjerrjen e Urdhërit të largimit të cilin ia kemi depozituar në rrugë postare.

Për sa më sipër znj. është mirë informuar për të gjitha ndryshimet në institucion siç janë informuar të gjithë punonjësit e DPKZ dhe dokumentet për iniciimin e procedurës të cilat ajo i kërkon dhe janë administruar brendshëm në institucionin nuk janë akte në të cilat ajo ka firmosur apo ka qënë pjesë e komisioneve për hartimin e tyre.

Drejtorja që znj. drejtonte ishte një drejtori pa funksion e cila nuk e justifikonte në asnjë dokument veprimtarinë e saj të punës dhe nuk ishte domosdoshmëri apo në nevojat e DPKZ që të vazhdonte funksionin e saj, për këtë arsye kaloi si Sektor i Edukimit, në varësi të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Edukimit. Bëjmë të ditur sërish se znj. u lëviz në detyrë për mirëfuksionimin e pozicionit të punës me synim arritjen e qëllimeve dhe objektivave të qarta që ka “Sektori i Edukimit” në DPKZ.”

Bashkëlidhur këtij e-mail-i Autoriteti Publik ka vendosur Urdhrin nr. 11 Prot., datë 21.01.2025 “Për lëvizje në detyrë”, shkresën nr. 101/1 Prot., datë 28.01.2025 “Kthim përgjigje”, si dhe Urdhrin nr. 32, datë 09.01.2025 “Për miratimin e strukturës organike të Drejtorisë së Përgjithshme të Kopshtit Zoologjik”.

Duke qenë se shkresa e sipërcituar sqaronte situatën e ndërprerjes së marrëdhënies së punës dhe nuk i përgjigjej kërkesës për informacion datë 02.02.2025, Zyra e Komisionerit vijoi me inspektimin pranë Autoritetit Publik. Gjatë inspektimit, grupi i inspektimit kontaktoi me koordinatoren për të drejtën e informimit pranë Autoritetit Publik, e cila, sqaroi se: “Kërkesa për informacion, ka mbërritur direkt pranë DPKZ. Jam vënë në dijeni nga Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit mbi ankimin që ka kryer znj. pranë kësaj të fundit. Pasi kam vënë në dijeni DPKZ-në mbi ankimin, kjo e fundit ka

kthyer përgjigje, të cilën ja kam vënë në dispozicion dhe Zyrës së Komisionerit, cituar si më sipër.”

Për sa më sipër, grupi i inspektimit kërkoi të kontaktojë me përfaqësuesen e DPKZ, e cila nga deklarimi i koordinatorit rezultoi se i është deleguar për trajtim kërkesa për informacion.

Përfaqësuesja e DPKZ sqaroi se: *“Kërkesa e znj. datë 02.02.2025 ka mbërritur pranë DPKZ në datë 04.02.2025 e cila është konsideruar e trajtuar me përgjigjen e kërkesës/kundërshtimit në shkresën e datës 24.01.2025, ku znj. i është vënë në dispozicion i gjithë dokumentacioni për të dytën herë rradhazi si fizikisht datën e Urdhrit të lëvizjes në detyrë nga sektori i Burimeve Njerëzore si dhe me anë të shkresës nr. 101/1 prot. datë 28.01.2025 ku znj. i është vënë në dispozicion i gjithë dokumentacioni si:*

- 1. Urdhrit nr. 32, datë 09.01.2025 “Për miratimin e strukturës organike të Drejtorisë së Përgjithshme të Kopshtit Zoologjik”.*
- 2. Urdhri i lëvizjes në detyrë nr. 45 prot., datë 21.01.2025.*
- 3. Urdhrit nr. 10, datë 21.01.2025 për riorganizimin e strukturës organizative të Drejtorisë së Përgjithshme të Kopshtit Zoologjik.*

Gjithashtu i kemi kthyer përgjigje dhe shkresës së ardhur me datë 11.03.2025, me shkresën nr. 216/2 Prot., datë 19.03.2025.”

Grupi i inspektimit kërkoi të informohet se cili është dokumentacioni që disponohet nga Autoriteti Publik sipas kërkesës për informacion, si dhe qëndrimin përfundimtar në lidhje me çështjen objekt inspektimi.

Përfaqësuesja e DPKZ, sqaroi se: *“Dokumentacioni që disponohet lidhur me procedurën e ristrukturimit është si vijon:*

- 1. Kërkesë për miratimin e ndryshimit të strukturës së Drejtorisë së Përgjithshme të Kopshtit Zoologjik nr. 604 prot., datë 26.12.2024.*
- 2. Urdhrit nr. 32, datë 09.01.2025 “Për miratimin e strukturës organike të Drejtorisë së Përgjithshme të Kopshtit Zoologjik”.*
- 3. Urdhrit nr. 10, datë 21.01.2025 “Për riorganizimin e strukturës organizative të Drejtorisë së Përgjithshme të Kopshtit Zoologjik”, shoqëruar me aparatin organizativ.*

Dokumentacioni që i përket pikës 2 dhe pikës 3 (kopje e urdhrit) i është vendosur në dispozicion kërkuarës. Ndërkohë, pasi u bëmë me dije nga grupi i inspektimit që ankuesja kërkon të gjithë dokumentacionin e disponuar sipas objektit të urdhrit të inspektimit, kërkohet mirëkuptimin e Zyrës së Komisionerit për vendosjen në dispozicion të këtij dokumentacioni brenda datës 28.03.2025”.

Në këto kushte, Komisioneri, me shkresën nr. 817/6 Prot., datë 04.04.2025 e ka konsideruar të përfunduar shqyrtimin e ankesës, pasi në vijim të inspektimit të ushtruar, Autoriteti Publik me e-mail-in datë 27.03.2025, si dhe shkresën nr. 238/1 Prot., datë

28.03.2025, ka vendosur në dispozicion dokumentacionin e zotëruar, sipas parashikimeve të LDI, duke përmbushur në këtë mënyrë qëllimin e këtij ligji.

Për sa më sipër trajtuar, referuar vijimit të ankimit të ankueses, për marrjen e masave dhe sanksionimin e personave përgjegjës, Komisioneri thekson se, LDI ka për qëllim të nxisë përforcimin e integritetit, transparencës e përgjegjshmërisë së autoriteteve publike dhe çdo subjekti që ushtron funksione publike. Objekti dhe qëllimi i LDI është garantimi i marrjes së informacionit për t'i shërbyer interesit publik, ndërkohë çështjet me karakter individual, siç janë ato që lidhen me marrëdhëniet e punës, rregullohen dhe garantohen plotësisht nga akte ligjore dhe organe të tjera të krijuara posaçërisht për zgjidhjen e këtyre problematikave.

Ky qëndrim i Komisionerit, gjen mbështetje edhe në ligjin nr. 45/2022 për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës “Për aksesin në dokumente zyrtare”. Në hyrje të Konventës Tromsø, si instrumenti i parë juridik ndërkombëtar që njeh një të drejtë të përgjithshme të qasjes efektive në dokumentet publike të mbajtura nga autoritetet publike në vendet e Këshillit të Evropës, parashikohet se: *“...duke pasur parasysh rëndësinë në një shoqëri pluraliste dhe demokratike të transparencës nga ana e autoriteteve publike; duke pasur parasysh se ushtrimi i të drejtës për akses në dokumentet zyrtare:*

- i. *ofron një burim informacioni për publikun;*
- ii. *ndihmon publikun në formimin e një opinioni për gjendjen e shoqërisë dhe autoritetet publike;*
- iii. *nxit integritetin, efektshmërinë, efikasitetin dhe përgjegjshmërinë e autoriteteve publike, duke i ndihmuar në këtë mënyrë që të konfirmojnë legjitimitetin e tyre; si rrjedhojë, duke pasur parasysh se të gjitha dokumentet zyrtare janë, në parim, publike dhe mund të mos bëhen publike vetëm për mbrojtjen e të drejtave të tjera dhe interesave legjitime”.*

Gjithashtu, në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku parashikohet se e drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

Për rrjedhojë, duke qenë se personat përgjegjës pranë Autoritetit Publik kanë përmbushur detyrimin duke vendosur në dispozicion dokumentacionin e zotëruar dhe gjatë hetimit administrativ ka rezultuar se nuk jemi para një rasti të refuzimit të së drejtës për informim, por trajtim të një kërkesë në vijim të ndërprerjes së marrëdhënieve të punës, e cila trajtohet sipas legjislacionit të posaçëm, Komisioneri vlerëson se nuk ka vend për të vijuar me aplikimin e sanksioneve të parashikuara nga shkronja “a” e pikës 2 të nenit 18 dhe pika 4 e nenit 19 të LDI.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjën c) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën

e informimit”, i ndryshuar, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Rrëzimin e ankesës me nr. 817/7 Prot., datë 16.04.2025, të znj. , kundër Autoritetit Publik “Bashkia Tiranë/Drejtoria e Përgjithshme e Kopshtit Zoologjik”, me objekt “Ankim për zbatimin e ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar”.
2. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar.
3. Ky vendim u shpall sot në datë 28.04.2025.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi